

VENDIM
Nr.1496, datë 19.11.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1184, DATË 20.8.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT E TË EMËRIMIT, TË AFATEVE TË KALIMIT NGA NJË NIVEL MË I ULËT NË NJË NIVEL MË TË LARTË KARRIERE DHE PËR MARRJEN E MASAVE DISIPLINORE PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS TATIMORE QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20, pikat 2 e 3, e 22 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1184, datë 20.8.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3 të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Kategoria C1 i përgjigjet klasifikimit: nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues. Në këtë kategori përfshihen funksionet: përgjegjës sektori/zyre në drejtorinë rajonale, përgjegjës zyre në task forcë, inspektor I, inspektor i auditit të brendshëm, përgjegjës sektori në drejtoritë mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.”.

“b) Shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë vijon:

“dh) Kategoria C2 i përgjigjet klasifikimit: nëpunës civil i nivelit ekzekutues. Në këtë kategori përfshihen funksionet: inspektor II dhe specialist i nivelit të parë dhe të dytë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe drejtoritë rajonale.”.

c) Shkronja “e” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“e) Kategoria C3 i përgjigjet klasifikimit: nëpunës civil i nivelit ekzekutues. Në këtë kategori përfshihet funksioni: specialist i nivelit të ulët.”.

ç) Shkronja “ë” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) Kategoria D1 përfshin personelin ndihmës si: nëninspektor dhe sekretar.”.

d) Shkronja “f” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“f) Kategoria D2 përfshin personelin ndihmës, si llogaritar, arkivist, protokollist, magazinier, shofer, centralist etj., dhe personel tjetër, të ngjashëm me to.”.

dh) Pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g”, me këtë përmbajtje:

“g) Kategoria D3 përfshin personelin tjetër ndihmës, që kryen shërbimet sanitare dhe të mirëmbajtjes së zyrave etj.”.

2. Shkronja “b” e pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Testimi bëhet me shkrim dhe me gojë dhe ndarja e pikëve të testimit bëhet në përputhje me vendimin nr.231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave. Ministri i Financave ngre një komision me 5 anëtarë. Kryetar i komisionit është zëvendësudrejtori i shërbimeve mbështetëse dhe anëtarë, drejtori/përfaqësuesi i zyrës/sektorit të personelit, eprori direkt për pozicionin e vendit të shpallur të lirë dhe dy personalitete të fushës ekonomiko-financiare dhe juridike. Personat që nuk janë pjesë e administratës tatimore, përfitojnë shpërbllim, në përputhje me vendimin nr.231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave, dhe paguhen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.”.

3. Paragrafi i tretë i pikës 7.2 “Procedura për ngritjen në kategoritë B e A” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Testimi bëhet me shkrim dhe me gojë. Ministri i Financave ngre komisionin e përzgjedhjes për kategoritë B e A, të përbërë nga 5 anëtarë. Kryetar i komisionit është

zëvendësdrejtori i shërbimeve mbështetëse dhe anëtarë, zëvendësdrejtori i operacioneve, zëvendësdrejtori i informacionit dhe menaxhimit të të ardhurave dhe dy personalitete të fushës ekonomiko-financiare dhe juridike.”.

4. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha